

STATUTI I SHOQËRISË
" DEEK-Group "
SHPK

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

Kreu I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesi

(1) Sot, më **10/01/ 2023**, në Gramsh, themeluesi, ka krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "DEEK- Group" shpk.

(2) Themeluesi i shoqërisë është :

- **Z. Dritan Konica**, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili identifikohet me Nr. letërnjoftimi 034248643 dhe numër personal H11114014H, lëshuar më 17.05.2019,

Neni 2
Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetet e mëposhtme si :

Ndërtim dhe zbatim punimesh të veprave ndërtimore të të gjitha llojeve sipas emërtesave të legjislacinit shqiptar.

Investime në ndërtime civile- industriale, godina banimi, kapanone industrial dhe në ndertime turistike.

Nderrmarje ndërtimi për vete dhe për llogari të të treteve në kryerjen e veprimtarive ndërtimore, në ndërtime civile-industriale, godina bujqesore, turistike dhe kompletimi me instalimet elektrike, hidrosanitare..etj që lidhen me zbatim e punimeve ndërtimore, si dhe punime për rikonstruksion të: godinave të të gjitha llojeve, rrugeve të cdo kategorie, autostrada, mbikalime, hekurudha, punime nëntokesore, ura e vepra arti, ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje, ndërtime hidroteknike, mbrojtje lumore, sistemime hidraulike e bonifikime, barriera dhe mbrojtje lumore, diga, damba, tunele. ndërtime për n/stacione elektrike, linja të tensionit të larte të ulet e të mesem dhe shpërndarjen e energjise. Ndërtim impjante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri dhe mirëmbajtjen e tyre. Impiante ngritëse dhe transportuese. Ndërtim hidrocentrale, prodhim të energjise elektrike dhe shitje të energjise elektrike. Ndërtim, montim, riparim, import eksport i dhomave frigoriferike dhe furrave të tharjes për produktet bujqesore.

Import eksport i kapanoneve industriale, strukturave si pjesëve përbërese si dhe elemente të lidhur dhe në shërbim të tyre.



Veprimtari private në fushën e projektimit, mbikqyrje kolaudim, menaxhimit dhe ndërtimin e linjave elektrike të TU, TM, TN , mbitokesore (ajrore) dhe nëntokësore (kabllore) për energjinë elektrike, telekomunikacionin, nënstacione elektrike TM & TN, dhe tensionit të mesëm TM/TN (kabina elektrike). Import- Eksporte të materiale elektrike për nënstacione të TU, TM, TN dhe të transformatoreve të fuqive dhe kapaciteteve të ndryshme. Mirmbajtje, remont, profilaktik të mesëm e kapital të transformatorëve elektrik, paisjeve elektrike të cdo lloji dhe kapaciteti. Studim, projektme, mbikqyrje kolaudim dhe realizim të impianteve për mbrojtjen nga zjarri. Studime, projektme mbikqyrje dhe kolaudim dhe realizim të impianteve elektrike civile dhe industriale. Konsulence teknike, mbikqyrje dhe kolaudim, studim projektim dhe realizim të punimeve civile dhe industriale, rrejteve inxhinierike etj. Shoqëria mund të realizoj drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë cdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare dhe të hyaj, si dhe të hyjë në marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi pse ortakërie me persona të tretë, privatë ose publike, vendase ose të huaj.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një kohë të pacaktuar .

Neni 4

Selia

Selia e shoqërisë do të ndodhet në adresën: Fshatin “ Kocaj “, Njësia administrative “ PISHAJ” bashkia Gramsh, në ZK nr. 2167, pasuria nr.93/1 (në sipërfaqen prej 40 m2).

Kreu II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Lekë (*sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë*). Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtme:

1. **Ortaku i vetëm Z.Dritan Konica**, shtetas Shqiptar numër personal H11114014H, Zotërues i 1 (një) Kuote, që përben 100 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë , me vlerë të përgjithshme 100,000 leke..

Kontributi i ortakut të vetëm mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë. Ortaku e një shoqërie me përgjegjësi

të kufizuar i vlerësojnë kontributet në natyrë në marrëveshje dhe i shpreh vlerat e tyre në para. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga ortakut i vetëm, i cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Neni 7 **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie ose shit blerjeve të kuotave përkatëse.

KREU III **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**


Neni 8 **Organi Vendimmarrës**

Organi vendimmarrës është ortakut i vetëm.

Ortakut i vetëm, është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Ortakut i vetëm është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të audituesve ligjore;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike.
- dh) miratimin dhe marrjen e kredive/huave nga bankat e nivelit të dytë, paleve të treta kundrejt legjislacionit në fuqi.
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë .



3

- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) kalimin në statut aktiv ose pasiv.
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 9 **Administrimi**

- (1) Ortaku u vetëm, emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit/ve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Ortaku i vetëm është administratori i shoqërisë .

KREU IV **VITI FINANCIAR-EKSPERTËT**

Neni 10 **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 11 **Audituesi Ligjor**


Audituesi ligjor ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit audituesi ligjor përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V **PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

Neni 12 **Prishja dhe likuidimi**

- 1. Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :
 - a) kur mbaron kohezigjatja, për të cilën është e themeluar;



4

b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;

c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;

d) në rastet e pavlefshmerisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";

dh) në raste të tjera, të parashikuara në statut;

e) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;

f) për çdo shkak tjetër të vendosur nga ortaku i vetëm .

2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", "dh", "e" dhe "f", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga ortaku i vetëm e parashikuar sipas të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

3. Pavaresisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shume shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat "a", "c", "d", "dh", "e" dhe "f", të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkak i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundur të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

4. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjen "b", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

5. Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjen "d", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të këtij ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Në rast prishje dhe likuidimi të shoqërisë, Ortaku i vetëm , merr vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 (një) apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i vetëm.

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14



Mosmarrëveshjet


Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

ORTAKU I VETËM

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

" DEEK- Group" shpk

Z. Dritan KONICA

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Dritan Konica', is written over the printed name.